

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: MARRËVESHJES KUADËR: “Blerje Artikuj ushqimorë
ndarë në 2 (dy) lote”** si më poshtë:

- Loti I. “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”
- Loti II “Blerje peshk”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03311000-2, 15100000-9, 15110000-2, 15111200-1, 15113000-3, 15131100-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 26,083,069.78 (njëzet e gjashtë milion e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH** ose 265,503.56 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tre pikë pesëdhjetë e gjashtë) EURO pa TVSH., i ndarë në lote si më poshtë vijon:

- **Loti I. “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”** me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **22,866,269.78** (njëzet e dy milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 232,759.26 (dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë njëzet e gjashtë) EURO pa TVSH.
- **Loti II. “Blerje peshk”** me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër **3,216,800** (tre milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH** ose 32,744.30 (tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e katër mijë e tridhjetë) EURO pa TVSH.

Vlerat e mësipërme janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 25.11.2024, me kurs këmbimi 98.24 (nëntëdhjetë e tetë pikë njëzet e katër) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e organit qëndror blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT - LOTI 1 “BLERJE MISH DHE NËNPRODUKTET E TIJ ”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore

pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: sipas pikës 2.3

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të Lotit 1**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit të parë me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për*

“Miratimin e rregullav etë prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **Liçensë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”** të lëshuar nga QKB (e vlefshme) me veprimtari në përputhje me objektin e prokurimit (Lotit I) dhe **Liçensën “II.1.B - Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)** të lëshuar nga QKB (e vlefshme).

(Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).

Argumentimi: *Kërkesa për paraqitjen e licensave të mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40, pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar; nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambjentet/stabilimentet dhe licencat perkatese per keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomikë duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Qënësia e këtyre licensave garanton AK se operatori ekonomik lidhur me stabilimentin që disponon në një rën nga format e sipërcituara ka përmbushur të gjithë parametrat e kërkuar dhe si rrjedhojë është pajisur me këto lloj liçensash për kryerjen e veprimtarisë përkatëse.*

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është prodhues duhet të paraqesë **Leje Mjedisit të tipit A ose B në emër të tij me përshkrim të veprimtarisë ID 7.7/a për thertore**, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 të LPP si dhe konform përcaktimeve të bëra në ligjin nr 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar. Kërkesa për qënësinë e kësaj leje mjedisore kërkohet vetëm dhe vetëm për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se veprimtaria për thertore bëhet në përputhje me rregullat mjedisore si dhe duke patur një qasje pozitive edhe miqësore kundrejt natyrës dhe mjedisit në tërësi. Në thertore kryhen procese pune të cilat shkaktojnë dhe gjenerojnë ujra industriale dhe mbetje të tjera të*

cilat mund të shkaktojnë ndotje në ujë dhe tokë, duke krijuar ndikim për biodiversitetin dhe shëndetin e popullsisë.

Pajisja me leje mjedisi siguron që veprimtaritë e përcaktuara të jenë në përputhje me masat e mbrojtjes së mjedisit.

Parandalimi i ndotjeve dhe mbetjeve të rrezikshme siguron një mjedis më të sigurt për popullsinë. Së fundmi LPP dhe RRPP me ndryshimet që kanë pësuar kanë sjellë në vëmendje dispozita të cilat lidhen dhe të orientojnë drejt prokurimit të gjelbër. Theksojmë se VKM nr 498 datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar”, sipas të cilit u ndryshua edhe neni 25 “Kriteret e Kualifikimit” parashikon se Autoritetet Kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta dhe specifikimeve **të zbatojnë legjislacionin mjedisor**, social e të punës – **në mënyrë që të të ulet ndikimi negativ në mjedis**. Pra përfshirja e kriterëve të gjelbra impakton në atë që promovohet gjithnjë e më shumë dhe që quhet “Prokurimi i qëndrueshëm”, pra një proces ku Autoritetet Kontraktore përmbushin nevojat e tyre për mallra, shërbime ose pune në një mënyrë duke impaktuar në minimizimin e dëmtimit të mjedisit.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës nëse është prodhues duhet të paraqesë **Leje mjedisi tipi A ose B në emër të tij me përshkrim të veprimtarisë ID 6.2 për “Trajtim të ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen”** të lëshuar nga QKB.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në:

- Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (LPP), neni 77
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar (RrPP), nenet 25 dhe 40
- Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 6(1), gërma c/ii
- Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar
- Ligjin nr. 29, datë 04.04.2024 “Për burimet ujore”

Përmes vendosjes së kriterëve të kualifikimit në përgjithësi dhe kriterit të mësipërm në veçanti për lotin 1, AK synon verifikimin nëse veprimtaria e operatorëve ekonomikë ofertues përputhet me kuadrin rregullator në fuqi për prokurimin publik dhe fusha të tjera specifike ligjore e nënligjore, ku objekti i prokurimit shtrin ndikimin. Përmes këtij kriteri AK ka për qëllim njohjen e kapaciteteve teknike e profesionale të operatorëve ekonomikë në funksion të realizimit të objektit të prokurimit në cilësi dhe kohë. Njëkohësisht, me vendosjen e këtij kriteri kërkohet të sigurohet, se gjatë përmbushjes së detyrimeve kontraktore me autoritetet kontraktore përfituese, kontraktuesi të zbatojë me rigorozitet dhe në vazhdimësi të gjitha rregullat në fuqi të lex specialis.

Ujërat industrialë të ndotur janë ujrat që gjenerohen në çdo rast nga proceset e prodhimit të industrisë me përmbajtje elementësh ndotës, të cilët përpara se të derdhen në rrjetin urban të kanalizimeve, duhet t'i nënshtrohen trajtimit. Sipas nenit 3, pika 104 të ligjit nr. 29, datë 04.04.2024 “Për burimet ujore”, me ujëra të ndotura industriale kuptohet çdo sasi uji që shkarkohet nga objekte që përdoren për të zhvilluar veprimtari tregtare ose industriale, përveç ujërave të ndotura shtëpiake dhe ujërave të reshjeve. Ndër llojet dhe burimet e ndotësve në ujërat industrialë mund të renditen ndotësit organikë si p.sh. industritë e përpunimit të mishit, fabrikat e letrës, ose kontaminimi nga yndyrnat, si p.sh. përpunimi i metaleve, gjithashtu edhe stabilimentet e përpunimit të produkteve të kafshëve si thertoret apo kompanitë e bulmetit, por jo vetëm.

Sipas nenit 6(1), gërma c/ii të ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, “Personat fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve shkarkon ujëra të ndotura, detyrohen të marrin masat që: (...) c) të administrojnë dhe të trajtojnë ujërat e ndotura nëpërmjet: (...) ii) ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të trajtimit, në përputhje me kërkesat e veçanta, sipas degës së industrisë, së cilës i përket veprimtaria;”.

Pa u kufizuar në arsyetimet e mësipërme, rëndësia e mbrojtjes së mjedisit është theksuar së fundmi edhe me ndryshimet e reja në legjislacionin e prokurimit publik. Me vendimin nr. 498, datë 01.08.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave ‘Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, të ndryshuar” është modifikuar neni 25 i RrPP, me përmbajtje si vijon: “ (...); 3. Autoritetet/entet kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të LPP-së, si edhe në hartimin e specifikimeve teknike, sipas parashikimeve të nenit 36, të LPP-së, të zbatojnë, përveç këtyre rregullave për prokurimin publik, edhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë vijon: (...); c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.”

Ky kriter vlerësohet proporcional dhe i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, si dhe në përputhje me frymën e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke theksuar, por pa u limituar në, garantimin e eficiencës së procedurës së prokurimit, pjesëmarrjes së gjerë në procedurat e prokurimit publik, mosdiskriminimin e operatorëve ekonomikë të interesuar, etj. Thënë ndryshe, ky kriter nuk synon pengimin e operatorëve ekonomikë, por garantimin se kërkesat mjedisore sipas legjislacionit në fuqi zbatohen me efektivitet në veprimtarinë e përditshme.

Pra përfshirja e kriterëve të gjelbra impakton në atë që promovohet gjithnjë e më shumë dhe që quhet “Prokurimi i qëndrueshëm”, pra një proces ku Autoritetet Kontraktore përmbushin nevojat e tyre për mallra, shërbime ose pune në një mënyrë duke impaktuar në minimizimin e dëmtimit të mjedisit.

5. Nëse operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i produkteve ushqimore të Lotit 1, duhet të ketë **Kontratë/a furnizimi me prodhues të cilët janë të licensuar me: Liçensë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”** me veprimtari sipas objektit të prokurimit (Lotit I) dhe të jenë të pajisur me lejet mjedisore sipas përcaktimit në kriterin 3 dhe 4 të këtij loti.

Për përmbushjen e këtij kriteri të paraqiten kontrata/t e furnizimit të vlefshme dhe *Liçensë e kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”* e vlefshme e prodhuesit me veprimtari sipas objektit të prokurimit (Lotit I) e lëshuar nga QKB si edhe lejet mjedisore përkatëse sipas përcaktimit të bërë në kriterin 3 dhe 4 të këtij loti.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Gjithashtu ky kriter është vendosur edhe në përputhje me rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik me Nr 6732 prot dt 21.10.2020 mbi “Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumentave të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë edhe shërbime” pika 2 ku citohet se:

“Në disa procedura prokurimi për produktet ushqimore të kërkuara si mish dhe fruta -perime etj..... AK kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë në pronësi apo në përdorim thertore dhe serë. Ndërkohë produktet e kërkuara mund të sigurohen edhe nëpërmjet kontratave të

furnizimit me subjekte të tjera që operojnë në fushën e tregëtimit të këtyre produkteve dhe që jo domosdoshmërisht janë thertore apo kanë serë por që produktet e tyre i tregëtojnë në përputhje me kërkesat ligjore.

Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Për këtë arsye, lind e nevojshme që të garantohet AK dhe të krijojë bindjen se furnizimi i ushqimit do të jetë i pandërprerë për të mos krijuar impakt tek konsumatori. Kontratat e furnizimit sigurojnë AK që në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues por mund të jetë importues apo tregëtar i thjeshtë të kenë një marrëveshje të qëndrueshme me prodhuesin, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në furnizim gjithashtu janë tregues edhe për një marrëdhënie të qëndrueshme me prodhuesin dhe ky fakt mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë së produktit, pasi prodhuesi është i angazhuar për të përmbushur standardet e kërkuara duke qënë se është i licensuar në atë fushë veprimtarie. Citimi se ofertuesit e mundshëm ekonomikë të cilët nuk janë prodhues të paraqesin licensën e prodhuesit ku furnizohen, siguron AK që produktet e furnizuara të jenë në përputhje me standardet e kërkuara dhe objektin e prokurimit për lotin I. Kjo ndihmon në garantimin e cilësisë së lartë të produkteve të ofruara, siguron gjurmueshmërinë e sigurisë ushqimore ç'ka impakton direkt jetën edhe shëndetin e konsumatorit fundor të cilët kryesisht janë spitale, institucione që ofrojnë shërbim kundrejt target grupeve në nevojë sic mund të jenë foshnje, fëmijë apo të moshuar Paraqitja e licencës së prodhuesit edhe në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është vetë prodhuesi rrit transparencën dhe përgjegjësinë për garantimin e sigurisë ushqimore. Në rast të ndonjë problemi me produktet ushqimore, është më e lehtë të gjurmohet burimi dhe të merren masat e duhura për të adresuar çështjen. Sigurimi që prodhuesi ka licencën e duhur ndihmon në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore për sigurinë ushqimore. Kjo siguron që produktet të jenë të sigurta për konsum dhe duke kërkuar që prodhuesi të ketë licencën e duhur, rrit besueshmëria e furnizuesve dhe sigurohet Autoriteti Kontraktor që ata janë të kualifikuar dhe të autorizuar për të prodhuar dhe shpërndarë ushqime.

Operatorët Ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë se duhet të zbatojnë me përpikmëri kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar dhe të gjitha akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushqimin lidhur me furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Përsa i përket kërkesës për paraqitjen e lejeve mjedisore me të cilat operon furnitori i tyre është bërë për tu siguruar se ky furnitor i ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e mjedisit lidhur me veprimtarinë që ushtron duke u siguruar kështu që edhe qasja e veprimtarisë së tij kundrejt mjedisit është sa më miqësor dhe konform rregullave për mjedisin.

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme), si më poshtë:

a. Çertifikatën SSH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika

e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë SSH EN ISO 22000:2018, është vendosur në bazë të nenit 79 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion çertifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

3-Standarti ISO 22000 specifikon, kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 u drejtohet të gjitha kompanive që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor dhe mund të zbatohet nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga madhësia apo kompleksiteti i tyre.

ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:

- Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor
- Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete)
- Menaxhim sistematik
- Programet e nevojshme
- Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)

Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:

- Fokus ndaj klientit
- Angazhimi i menaxhimit të lartë
- Pjesëmarrje aktive e personelit
- Qasje ndaj procesit
 - Përmirësim i vazhdueshëm
 - Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion

Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara

- b. Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 për “Menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave

të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

c. Çertifikatën SSH EN ISO 14001:2015 për “Sistemin e menaxhimit mjedisor”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Zbatimi i një sistemi të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14001 lejon kompanitë të menaxhojnë në mënyrë sistematike aspektet specifike mjedisore të të gjithë aktiviteteve, me qëllim të promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit mjedisor të proceseve prodhuese.

Çertifikimi i Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit lejon:

– Përmirësimin e efikasitetit të proceseve dhe/ose shërbimeve të prodhimit me reduktim të kostove (sistemi nënkupton matjen e efikasitetit të tij përmes indekseve, monitorimit të konsumit, etj.);

– të kontrollojë dhe të monitorojë përputhshmërinë me legjislacionin. Kush zbaton një sistem të menaxhimit të mjedisit duhet të njohë më mirë të çështjet e biznesit që ndikojnë në mjedis (lejet dhe praktikat e lidhura me emisionet, shkarkimet e ujit, mbeturinave, konsumi i

energjisë, etj), duke reduktuar ndjeshëm mundësinë e sanksioneve apo gjykimeve civile ose penale dhe lehtësimin e marrjes së lejeve mjedisore;

– përmirësimi i performancës mjedisore;

– kanë një mjet marketingu të vlerësuar, pasi kompanitë që respektojnë mjedisin janë dhe do të pranohen gjithnjë e më shumë pozitivisht nga tregu;

ISO 14001 garanton se furnizuesit e ushqimit

kujdesen për mjedisin. ISO 14001 tregon se ata menaxhojnë mirë ndikimet mjedisore të Prodhimit dhe transportit të ushqimit.

d. Çertifikatën H.A.C.C.P për sistemin e menaxhimit të autokontrollit në parimet H.A.C.C.P për “Higjenën” ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: Certifikata H.A.C.C.P (Analiza e Rrezikut dhe Pikat Kritike të Kontrollit) është thelbësore për sigurimin e higjienës dhe sigurisë ushqimore. Duke kërkuar këtë certificate, AK sigurohet që furnizuesit e ushqimeve ndjekin praktikën më të mira për parandalimin e rreziqeve të sigurisë ushqimore. Kjo çertifikate krijon një siguri që të gjitha proceset e prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit janë monitoruar dhe menaxhuar në përputhje me standardet e larta të sigurisë.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të jenë të vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur dhe garantuar sigurinë ushqimore dhe për të mbrojtur konsumatorin e fundit.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi të lotit 1 në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të

këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

9. Operatori ekonomik duhet të disponojnë minimumi 2 (dy) mjete transporti ATV (frigoriferik) për transportin e produkteve ushqimore/mish dhe nënproduktet e tij. Mjetet mund të jenë në pronësi, qera apo përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm).

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, brenda marrëveshjes kuadër duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, pozicionin gjeografik të autoriteteve kontraktore përfitues. Mjetet e kërkuara janë frigoriferike duke qënë se edhe artikujt që do të transportohen janë artikuj që duhet të transportohen në kushte higjieno sanitare dhe në temperaturën e duhur në mënyrë që këto artikuj të shkojnë të sigurt pranë Autoritetit Kontraktor përfitues dhe më pas deri tek konsumatori i fundit.

10. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës, për të realizuar shërbimin e transportit dhe shpërndarjen e artikujve ushqimore objekt prokurimi sipas lotit 1 në destinacion, si më poshtë :

Stafi	Nr.
Shofer	2 dy
Punonjes shperndarje	2 dy
Total	4 katër

- Për punonjësit e punësuar të paraqitet kontrate pune (e vlefshme).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 4 punonjësish, përkatësisht shofer/punonjës për shpërndarje që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen dhe shpërndahen në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT- LOTI 2 " BLERJE PESHK "

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas pikes 2.3

2.2Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të Lotit 2**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 42 pika 3 ku përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë 41.Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 43 Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 46 intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është nën kufirin e ulët monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për lotin e dytë është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 42 pika 3 e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 42/3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të këtij loti. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh

përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit të këtij loti është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të disponojë **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”** (e vlefshme) me veprimtari në përputhje me objektin e prokurimit të (Lotit II) të lëshuar nga QKB.

(Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40, pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar; nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambjentet/stabilimentet dhe licencat perkatese per keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomikë duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjiëno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Qënësia e kësaj license garanton AK se operatori ekonomik lidhur me stabilimentin që disponon në njërën nga format e sipërcituara ka përmbushur të gjithë parametrat e kërkuar dhe si rrjedhojë është pajisur me këtë lloj liçense për kryerjen e veprimtarisë përkatëse.*

3. Nëse operatori ekonomik ofertues nuk është vetë prodhues i produkteve ushqimore te Lotit 2, duhet të ketë **kontratë /a furnizimi me subjekte të liçensuar me Liçensë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”** me veprimtari sipas objektit të prokurimit (Lotit II).

Për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqitet **kontrata/t e furnizimit të vlefshme dhe Liçencë të kategorisë “II.1.A.1-Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”** të subjekteve të liçensuara me veprimtari sipas objektit të prokurimit (Lotit II), e vlefshme të lëshuar nga QKB.

Argumentimi: *Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Gjithashtu ky kriter është vendosur edhe në përputhje me rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik me Nr 6732 prot dt 21.10.2020 mbi “Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumentave të tenderit*

dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë edhe shërbime” pika 2 ku citohet se:

*“Në disa procedura prokurimi për produktet ushqimore të kërkuara si mish, fruta -perime etj.... AK kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë në pronësi apo në përdorim thertore dhe serë. **Ndërkohë produktet e kërkuara mund të sigurohen edhe nëpërmjet kontratave të furnizimit me subjekte të tjera që operojnë në fushën e tregëtimit të këtyre produkteve dhe që jo domosdoshmërisht janë thertore apo kanë serë por që produktet e tyre i tregëtojnë në përputhje me kërkesat ligjore.***

Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit. Për këtë arsye, lind e nevojshme që të garantohet AK dhe të krijojë bindjen se furnizimi i ushqimit do të jetë i pandërprerë për të mos krijuar impakt tek konsumatori. Kontratat e furnizimit sigurojnë AK që në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues por mund të jetë tregëtues të kenë një marrëveshje të qëndrueshme me subjekte të licensuar (duke nënkuptuar si të tillë jo vetëm prodhues por edhe /importues etj,..), duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve në furnizim. Gjithashtu këto kontrata janë tregues edhe për një marrëdhënie të qëndrueshme me subjektet e licensuar dhe ky fakt mund të ndihmojë në garantimin e cilësisë së produktit, pasi subjekti apo subjektet e licensuara janë të angazhuar për të përmbushur standardet e kërkuara duke qënë se janë të licensuar në atë fushë veprimtarie. Citimi se ofertuesit e mundshëm ekonomikë të cilët nuk janë prodhues të paraqesin licensën e subjekteve të licensuar ku furnizohen, siguron AK që produktet e furnizuara të jenë në përputhje me standardet e kërkuara dhe objektin e prokurimit për lotin 2. Kjo ndihmon në garantimin e cilësisë së lartë të produkteve të ofruara, siguron gjurmueshmërinë e sigurisë ushqimore ç’ka impakton direkt jetën edhe shëndetin e konsumatorit fundor të cilët kryesisht janë institucione që ofrojnë shërbim kundrejt target grupeve në nevojë sic mund të janë në rastin konkret të moshuarit. Paraqitja e licencës së subjekteve të licensuar edhe në rastin kur operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është vetë prodhuesi rrit transparencën dhe përgjegjësinë për garantimin e sigurisë ushqimore. Në rast të ndonjë problemi me produktet ushqimore, është më e lehtë të gjurmohet burimi dhe të merren masat e duhura për të adresuar çështjen. Sigurimi që këto subjekte kanë licencën e duhur ndihmon në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore për sigurinë ushqimore. Kjo siguron që produktet të jenë të sigurta për konsum dhe duke kërkuar që këto subjekte të kenë licencën e duhur, rritet besueshmëria e furnizuesve dhe sigurohet Autoriteti Kontraktor që ata janë të kualifikuar dhe të autorizuar për të prodhuar/importuar dhe shpërndarë ushqime.

Operatorët Ekonomikë duhet të mbajnë në konsideratë se duhet të zbatojnë me përpikmëri kërkesat e Ligjit Nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar dhe të gjitha akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushqimin lidhur me furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatat (të vlefshme), si më poshtë:

a.Çertifikatën SSH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika

e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Kriteri për Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë SSH EN ISO 22000:2018, është vendosur në bazë të nenit 79 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi.

3-Standarti ISO 22000 specifikon, kërkesat e përgjithshme për zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të një kompanie. ISO 22000 u drejtohet të gjitha kompanive që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në zinxhirin e furnizimit ushqimor dhe mund të zbatohet nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga madhësia apo kompleksiteti i tyre.

ISO 22000 është standardi më i lartë i certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. Parimet themelore të standardit janë:

- Kontroll efektiv në të gjithë zinxhirin e furnizimit ushqimor
- Komunikim efektiv midis të gjitha palëve të interesuara të zinxhirit të furnizimit ushqimor (biznese, furnitorë, klientë, autoritete)
- Menaxhim sistematik
- Programet e nevojshme
- Parimet e analizës së rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)

Standardi bazohet gjithashtu në parimet që janë të përbashkëta me standardet e sistemit të menaxhimit. Parimet e menaxhimit janë:

- Fokus ndaj klientit
- Angazhimi i menaxhimit të lartë
- Pjesëmarrje aktive e personelit
- Qasje ndaj procesit
 - Përmirësim i vazhdueshëm
 - Vendimmarrje e bazuar në dokumentacion

Menaxhim i marrëdhënieve me palët e interesuara

b. Çertifikatën SSH EN ISO 9001:2015 për “Menaxhimin e cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar)

konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

- c. Çertifikatën SSH EN ISO 14001:2015 për “Sistemin e menaxhimit mjedisor”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Zbatimi i një sistemi të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14001 lejon kompanitë të menaxhojnë në mënyrë sistematike aspektet specifike mjedisore të të gjithë aktivitetëve, me qëllim të promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit mjedisor të proceseve prodhuese.

Çertifikimi i Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit lejon:

– Përmirësimin e efikasitetit të proceseve dhe/ose shërbimeve të prodhimit me reduktim të kostove (sistemi nënkupton matjen e efikasitetit të tij përmes indekseve, monitorimit të konsumit, etj.);

– të kontrollojë dhe të monitorojë përputhshmërinë me legjislacionin. Kush zbaton një sistem të menaxhimit të mjedisit duhet të njohë më mirë të çështjet e biznesit që ndikojnë në mjedis (lejet dhe praktikat e lidhura me emisionet, shkarkimet e ujit, mbeturinave, konsumi i energjisë, etj), duke reduktuar ndjeshëm mundësinë e sanksioneve apo gjykimeve civile ose penale dhe lehtësimin e marrjes së lejeve mjedisore;

– përmirësimi i performancës mjedisore;

– kanë një mjet marketingu të vlerësuar, pasi kompanitë që respektojnë mjedisin janë dhe do të pranohen gjithnjë e më shumë pozitivisht nga tregu; ISO 14001 garanton se furnizuesit e ushqimit kujdesen për mjedisin. ISO 14001 tregon se ata menaxhojnë mirë ndikimet mjedisore të Prodhimit dhe transportit të ushqimit.

d. Çertifikatën H.A.C.C.P për sistemin e menaxhimit të autokontrollit në parimet H.A.C.C.P për “Higjenën” ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO*).

Argumentimi: *Certifikata H.A.C.C.P (Analiza e Rrezikut dhe Pikat Kritike të Kontrollit) është Thelbësore për sigurimin e higjienës dhe sigurisë ushqimore. Duke kërkuar këtë certificate, AK sigurohet që furnizuesit e ushqimeve ndjekin praktikat më të mira për parandalimin e rreziqeve të sigurisë ushqimore. Kjo certificate krijon një siguri që të gjitha proceset e prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit janë monitoruar dhe menaxhuar në përputhje me standardet e larta të sigurisë.*

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: *Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të jenë të vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrorjnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur dhe garantuar sigurinë ushqimore dhe për të mbrojtur konsumatorin e fundit*

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të peshkut në adresat e përcaktuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.*

7. Operatori ekonomik duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti ATV (frigoriferik) për transportin e peshkut. Mjeti mund të jetë në pronësi, qera apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë si :

- a. Akti që vërteton pronësinë, Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi,
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm),
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjeteve (të vlefshëm)

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, brenda marrëveshjes kuadër duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi, pozicionin gjeografik të autoriteteve kontraktore përfitues. Mjeti i kërkuar është frigoriferik duke qënë se edhe artikujt objekt loti nr 2 duhet të transportohen në kushte higjeno sanitare dhe në temperaturën e duhur në mënyrë që këto artikuj të shkojnë të sigurt pranë Autoritetit Kontraktor përfitues dhe më pas deri tek konsumatori i fundit.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës si me poshte :

Stafi	Nr.
Shofer	1 një
Punonjes per shperndarje	1 një
Total	2 dy

- Për punonjësit e punësuar të paraqitet kontrate pune (e vlefshme).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht shofer/punonjës për shpërndarje që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen dhe shpërndahen në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

***Shënim:** Operatori ekonomik i cili oferton në më shumë se sa një Lot, duhet të plotesoje në mënyrë kumulative kriterin për kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe furnizimet e meparshme të ngjashme. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, OE ofertues kualifikohet vetëm në lotin/et në të cilin/et oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.*

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Përlllogaritja e fondit limit është bërë nga struktura të specializuara / Grup pune pranë Autoriteteve Kontraktore përfituese për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në përputhje me katalogun / standardin e hartuar dhe miratuar të specifikimeve teknike për “Blerje artikuj ushqimorë” nga ish Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT